



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОБА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОБА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

**Seanca Plenare**

Seanca nr.02-29/16-06

Prishtinë, më 27 e 28 korrik 2006

Ndërtesa e Kuvendit, Salla e seancave plenare

**PROCESVERBAL**

Seanca filloi nga puna në ora 10,00 dhe e kryesoi kryetari i Kuvendit **Kolë Berisha**, ndërsa e ndihmoi **Sabri Hamiti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari i Kuvendit konstatoi se në Seancë janë të pranishëm 79 deputet dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

**REND DITE :**

1. Miratimi i rendit të ditës ,
2. Miratimi i procesverbalit nga seance e kaluar ,
3. Pyetjet e deputetëve ,
4. Shqyrtimi i Projektligjit mbi trashëgimin kulturore .
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit Nr.2004/5 për tregti me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë ,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit mbi Zonat industriale ,
7. Shqyrtimi i parë i Ligjit mbi parqet nacionale ,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Ushqim ,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përdorimin e gjuhëve ,
10. Shqyrtimi i propozimeve nga G/P për emërimin e anëtarit vendor në Këshillin e KPM –së ,

11. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për emërimin e kryesuesit të Bordit të Rregullatorit të Energjisë ,
12. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për emërimin e Zëvendës ministrit të Drejtësisë Altay Suroy dhe
13. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Ekonomi , Industri , Energjetikë , Miniera , Transport e Telekomunikacion , lidhur me raportin e ART-së për punën një vjeçare .

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

Për fjalë u paraqitën këta deputetë :

**Alush Gashi** , në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kërkoi që shqyrtimet sipas pikave 6. e 8 të Rendit ditës të hiqen nga Rendi i ditës në mënyrë që : lidhur më pikën e 6-të Projektligji mbi zonat e lira industriale t'i kthehet në rishqyrtim Qeverisë së Kosovës ndërsa , për sa i referohet pikës 8-të Projektligji për ushqim tu jepet kohë dy komisioneve parlamentare që t'i harmonizojnë qëndrimet: Komisioni për bujqësi , pylltari , zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapësinor si dhe Komisioni për shëndetësi , punë dhe mirëqenie sociale .

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet që Projektligji mbi zonat e lira industriale dhe Projektligji për Ushqim të hiqen nga Rendi i ditës së seancës plenare .

Rezultati i votimit ishte :

Për.....79,  
Kundër..... 0,  
Abstenim... 0.

Përfundim:

Kuvendi njëzëri miratoi propozimin që Projektligji për zonat e lira industriale dhe Projektligji për Ushqim të hiqen nga Rendi i ditës së seancës plenare .

**Gjylnaze Syla** , në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së kërkoi që në Rendin e ditës të përfshihen dy kërkesat e këtij Grupi : Hartimi i Kushtetutës së Kosovës dhe nxjerrja e Rezolutës për organizimin e diasporës kosovare dhe bashkëpunimi me institucionet e Kosovës.

**Kryesuesi** shpjegoi se të dyja këto kërkesa të Grupit parlamentar të AAK-së, kanë qenë në Rend të ditës në Kryesinë e Kuvendit dhe se aty janë marrë qëndrimet- përfundimet lidhur me procedimet e ardhshme me mocionet në fjalë.

Pas hudhjes në votim, propozimi nuk pati mbështetjen e deputetëve.



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

**Jakup Krasniqi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së kërkoi që pika e 13 e rendit të ditës – Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Ekonomi, Financa, Industri, Energjetik, Miniera, Transport e Telekomunikacion lidhur më punën njëvjeçare 2005 të hiqet nga Rendi i ditës ndërsa në një rën prej seancave të ardhshme të radhës të përfshihet si pikë e Rendit të ditës Shqyrtimi i Raportit të ART-së si dhe gjendja në telefonin mobile. Kërkoj që para Kuvendit të raportoj shefi i ART-së.

**Alush Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, e përkrahu kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së për heqjen nga rendi i ditës pikën e 13-të dhe e mirëpret propozimin që në një rën nga seancat plenare të ardhshme të raportohet lidhur më gjendjen në telefonin mobile.

Kryesuesi i hodhi në votim kërkesat e grupeve parlamentare të PDK-së dhe LDK-së  
Rezultati i votimit . ishte si vijon :

Për.....78 deputet,  
Kundër... .. 0 “

Përfundim:

Raporti për punën njëvjeçare 2005 bashkë me gjendjen në telefonin mobile, do të shqyrtohet në një rën nga seancat e shtatorit, ku do të raportoj shefi i ART-së.

**Nazmi Jashari**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s parashtrroi kërkesën që të raportohet lidhur me bisedat e delegacionit të Kosovës në Vjenë .

**Kryetari i Kuvendit, Kolë Berisha**, i informoi të pranishmit se sot në ora 12,00 kryetari i Kosovës, Fatmir Sejdiu, në emër të Grupit Negociator në bisedimet në Vjenë do t'i informoi deputetet e Kuvendit dhe se kjo do të jetë pikë e re e Rendit të ditës .

**Xhevat Bislimi** shpehu shqetësimin për propozimin për krijimin e një komune etnikisht e pastër serbe në komunën e Vitisë.

**Gjergj Dedaj**, kërkoi që puna e Grupit Negociator të jetë ma transparente pasi që mënyra siç është duke u veprua, shkelet sovraniteti i Kosovës si dhe që nga organet e sigurisë dhe ndjekjes të sqarohet tentimi i atentatit ndaj deputetit Sabit Rrahmanit .

## **2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të kaluar**

Deputetët **Hatixhe Hoxha , Fetah Berisha dhe Jonuz Kastrati** parashtruan disa vërejtje të cilat i referohen Transkriptit nga Seanca e kaluar .

**Nekibe Kelmendi** ndërhyri duke parashtruar në fjalën e saj se në Rend të ditës të Seancës plenare është miratimi i procesverbalit e jo i transkriptit .

**Kryesuesi** e hodhi në votim miratimin e Procesverbalit nga Seanca plenare e kaluar dhe i njëjti u miratua njëzëri pa asnjë vërejtje .

## **3. Koha për pyetje parlamentare**

Deputetja **Zylfije Hundozi**, ka parashtruar pyetje për ministrin për Ekonomi e Financa z. Haki Shatri. Në mungesë të këtij të fundit mbetet që përgjigjën ta marrë në Seancën e ardhshme.

Deputeti **Xhezair Murati** i parashtroi pyetjen ministrit për Kthim dhe Komunitete Sllavisha Petkoviq.

Ministri **Sllavisha Petkoviq** iu përgjigj pyetjes së deputetit Murati .

Deputetja **Zylfije Hundozi** ka parashtruar pyetje për ministrin e tregtisë dhe industrisë, z. Bujar Dugolli . Në mungesë të këtij të fundit mbetet që përgjigjën ta marrë në Seancën e ardhshme plenare .

Deputeti **Genc Gorani** parashtroi pyetje për Ministrin e Brendshëm Fatmir Rexhepin . Ministri Fatmir Rexhepi iu përgjigj pyetjes së deputetit Gorani .

Deputetja **Fatmire Mulhaxha - Kollçaku** kishte një pyetje për kryeministrin, Agim Çekun, por ai nuk ishte i pranishëm, andaj përgjigjja mbeti për Seancën e ardhshme plenare .

Deputetja **Sala Berisha- Shala** i parashtroi pyetje Ministrit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Ardian Gjinit .

Ministri **Ardian Gjini** iu përgjigj pyetjes së deputetes Berisha

Deputetja **Sala Berisha- Shala** i parashtroi pyetje Ministrit të Transportit dhe Postë Telekomunikacionit Qemajl Ahmetit .

Ministri **Qemajl Ahmeti** iu përgjigj në pyetjen e deputetes Berisha .

Deputeti **Xhevat Bislimi** i parashtroi pyetje Ministrit Energjetikës dhe Minierave Et'hem Çekut .

Ministri **Et'hem Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetit Bislimi .

Deputeti **Hydajet Hyseni** shfaqti shqetësimin për mosdhënjen e përgjegjës lidhur me mjetet e ndara për sanimin e pasojave të tërmetit në Gjilan.



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se pyetjet që nuk kanë marr përgjigje brenda dy seancave do të publikohen në Buletinin e Kuvendit.

**4. Shqyrtimi i parë i Ligjit mbi trashëgimin kulturore**

Zëvendës ministrja e Ministrisë së Kulturës, rinisë , sporteve dhe çështjeve jorezidente **Angjelina Krasniqi** e dha fjalën hyrëse për Ligjin në fjalë dhe propozoi që i njëjti të miratohet në parim .

**Nimon Alimusaj** , në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, i jepi mbështetje këtij Ligji dhe propozoi që i njëjti të miratohet në parim aq më parë pasi që ai është njeri prej standardeve esenciale i cili nevojitet që të përmbushët .

**Enver Hoxhaj** , në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së i jepi mbështetje dhe e përkrah miratimin e këtij Ligji në parim dhe njëherë propozojë që sa më shpejtë që të është e mundur të shkohet në lexim të dytë .

**Genc Gorani** , në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s gjithashtu e përkrah miratimin e Ligjit në parim

**Myrvete Dreshaj – Baliu** , në emër të Grupit parlamentar të AAK-së e përkrah miratimin e Ligjit në parim .

**Husnija Beshkoviq** , në emër të Grupit “Parlamentar “6+” e përkrah miratimin e Ligjit në parim .

**Gjergj Dedaj** , në emër të Grupit Parlamentar “Për Integrim” e përkrah miratimin e Ligjit në Parim .

Në debat moren pjesë deputetët: Mark Krasniqi Sanije Alijaj, Ragip Zekolli, Behxhet Brajshori, dh Qibrije Hoxha. Diskutimet janë pjesë e transkriptit.

Kryetari i Kuvendit e hodhi në votim miratimin në parim të Ligjit mbi trashëgimin kulturore.

Rezultati i votimit ishte si vijon :

Për \_\_\_\_\_ 64 deputet  
Kundër \_\_\_\_\_ 3 deputet  
Abstenime \_\_\_\_\_ 1 deputet

## **5. Informatë e Presidentit të Kosovës z. Fatmir Sejdiu lidhur me bisedimet e Grupit negociator të Kosovës në Vjenë**

Kryetari i Kosovës, **Fatmir Sejdiu**, në emër të Grupit Negociator të Kosovës në bisedimet në Vjenë i informoi deputetet e pranishëm lidhur me ecurinë e bisedimeve të deritashme të delegacionit të Kosovës në Vjenë, si dhe çështjet tjera të lidhura me këto bisedime .

## **6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit Nr.2004/5 për tregti me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë**

Zëvendësministri i Ministrisë se Tregtisë dhe Industrisë **Kadri Kryeziu** , në fjalën hyrëse lidhur me Projektligjin në fjalë sqaroi ndryshimet të cilat i behën Ligjit në fjalë duke propozua që të miratohet në parim Ligji në fjalë .

**Ibush Jonuzi** , në emër të Grupit parlamentar të LDK-së e përkrahu miratimin në parim të Projektligjit në fjalë .

**Xhevdet Neziri** , në emër të Grupit parlamentar të AAK-së, e përkrahu miratimin në parim të Ligjit në fjalë

Kryetari e hodhi në votim miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin e Ligjit Nr.2004/5 për tregti me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë .

Rezultati i votimit ishte si vijon :

Për \_\_\_\_\_ 61 deputet  
Kundër \_\_\_\_\_ 0 deputet  
Abstenime \_\_\_\_\_ 2 deputet

Përfundim:

Kryetari konstaton se me shumicën e votave, Kuvendi miratohet në parim Projektligjin për ndryshimin e Ligjit Nr.2004/5 për tregti me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë .

## **7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parqet nacionale**

Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe planifikimit hapësinor **Ardian Gjini** , në fjalën hyrëse jepi shpjegime të nevojshme dhe të domosdoshme lidhur me Projektligjin në fjalë duke propozuar që deputet t'a miratojnë në parim Projektligjin në fjalë .



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

**Shaban Halimi** , në emër të Grupit parlamentar të LDK-së, e mbështeti miratimin në parim të Projektligjit në fjalë .

**Selvije Halimi** , në emër të Grupit parlamentar të PDK-së e mbështeti miratimin në parim të Projektligjit në fjalë .

**Mazllom Kumnova** , në emër të Grupit parlamentar të AAK –së , me një vërejtje e cila i referohet emërtimit të Projektligjit :“nacionale” propozojë që ky emërtim të jetë në gjuhën shqipe :”kombëtare”. E mbështet miratimin në parim të Projektligjit në fjalë .

**Xhezair Murati** në emër të grupit parlamentar “6+” e mbështet miratimin në parim e Projektligjit në fjalë.

**Nekibe Kelmendi** , me disa vërejtje për vijat përkufizuese, e mbështet miratimin në parim të Projektligjit në fjalë .

Kryetari e hodhi në votim Projektligjin mbi parqet nacionale .

Rezultati i votimit ishte si vijon :

Për _____	59 deputet
Kundër _____	0 deputet
Abstenime _____	2 deputet

Përfundim:

Kryetari konstatoj se me shumicën e votave, Kuvendi miratoj në parim Projektligjin për parqet nacionale.

## **9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përdorimin e gjuhëve**

Kryetari i informoi deputetet lidhur më procedurat e shqyrtimit të këtij Projektligji si dhe raportet e komisioneve kryesore dhe komisionit përgjegjës – raportues.

Ai hodhi në votim veç e veç amendamentet e Komisionit funksional për shërbime publike, administratë lokale dhe media

Kuvendi miratoi këto amendamente : 3, 4a ,7a , 8 , 10 , 11 , 12 , 13 , 14 a , 17 , 18 , 19 , 20 , 21 , 22 , 23 , 26 , 27 , 28 , 29 , 30 , 31a , 32 , 33a , 34 , 35 , 36 , 37, 39, 40, 41, 42 dhe 43.

Kuvendi nuk i miratoi këto amendamente : 1 , 2 , 4b , 5 , 6 , 7b , 9 , 14b 15, 16, 24 , 25, 31b , 33b dhe 38 .

Më pastaj Kryetari kërkoj që deputetët të deklarohen për miratim të Projektligjit për përdorimin e gjuhëve në tersi, bashkë me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte si vijon :

Për \_\_\_\_\_ 52  
Kundër \_\_\_\_\_ 13.

Përfundim:

Kryetari konstaton se Kuvendi i Kosovës, me shumicën e votave, miratohet Ligjin për përdorimin e gjuhëve.

Në vazhdim të punës së Seancës Plenare , Kryetari i Kuvendit konstatoi se në sallë mungojnë një numër i konsiderueshëm i deputetëve dhe se nuk ka kuorum të domosdoshëm për të vazhduar mbledhjen prandaj , konformë Rregullës 32.2 të Rregullores për Punën e Kuvendit, e ndërpret mbledhjen duke paralajmëruar së seanca do të vazhdojë të nesërmen më datë 28 korrik 2006 me fillim nga ora 10,00.

**Datë 28 korrik 2006 ora 10,00**

**Vazhdimi i seancës plenare të datës 27 korrik 2006**

Seancën e kryesoj Kryetari i Kuvendit **Kolë Berisha**, ndërsa i ndihmoj **Sabri Hamiti** , anëtar i Kryesisë së Kuvendit .

### **10. Shqyrtimi i propozimeve nga Grupet parlamentare për emërimin e anëtarit vendor në Këshillin e Komisionit të Pavarur për Media**

Kryetari i Kuvendit i njoftoi deputetët se në pajtim me nenin 4.3 të Ligjit për Komisionin e pavarur për media dhe transmetim nr. 02/L-15, Kuvendi i Kosovës emëron anëtarin vendor të Këshillit të KPM-së .

Në pajtim me Procedurat për emërimin e anëtarit vendor në Këshillin e KPM-së, në kërkesë të Kryesisë së Kuvendit, Grupet parlamentare i kanë propozuar kandidatët dhe ate:

1. Adil Pireva nga (LDK-ja)
2. Ekrem Kryeziu nga (PDK-ja)
3. Maksut Shehu nga (ORA) dhe
4. Vjosa Shala-Pallaska nga (AAK-ja)

Mëqë janë propozuar më shumë se një kandidat, emërimi i kandidatit duhet të bëhet me votim të fshehtë dhe kërkon shumicën e votave të deputetëve prezent.





PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

Për mbarëvajtjen e votimit do të përkujdeset Komisioni i përberë nga tre zyrtar të departamentit ligjor, nën monitorimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Pas procedimit me votim të fshehtë, Kryetari shpalli rezultatin si vijon :

1. Për Adil Pirevën .....42 deputet ,
2. Për Ekrem Kryeziun .....23 deputet ,
3. Për Vjollca Shala-Pallaska.....7 deputet dhe
4. Për Maksut Shehun .....4 deputet.

Fletëvotime të pavlefshme ishin tri /3/.

Kryetari konstaton se z. Adil Pireva është zgjedhur anëtar vendor në Këshillin e Komisionit të pavarur për media.

**11. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e Kryesuesit të Bordit të Rregullatorit të Energjisë**

Kryetari i Kuvendit i njoftoi deputetët lidhur me Propozimin e Qeverisë së Kosovës për kandidatin për emërimin e kryesuesit të Bordit të Rregullatorit të Energjisë dhe ate:

- Ali Hamiti , dr. i inxhinierisë elektrike nga Prishtina .

Kryetari i Kuvendit e hodhi në votim Propozimin e Qeverisë së Kosovës për kandidatin për postin e kryesuesit të Bordit të Rregullatorit të Energjisë z. Ali Hamiti .

Rezultati i votimit ishte si vijon :

- Për \_\_\_\_\_ 50 deputet ,
- Kundër \_\_\_\_\_ 10 deputet ,
- Abstenime \_\_\_\_\_ 14 deputet .

Kryetari konstaton se z. Ali Hamiti është emëruar kryesues i Bordit të Rregullatorit të Energjisë.

**12. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e Altay Suroy , zëvendësministër të Drejtësisë**

Kryetari i njoftoi deputetët lidhur më Propozimin e Qeverisë së Kosovës për kandidatin për emërim në postin e zëvendësministrit të Drejtësisë – z. Altay Suroy.

Kryetari i Kuvendit e hodhi në votim propozimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e Altay Suroy , juristit të diplomuar nga Prizreni në postin e zëvendësministrit të Drejtësisë . Rezultati i votimit ishte :

- Për \_\_\_\_\_ 34 deputet ,
- Kundër \_\_\_\_\_ 32 deputet ,
- Abstenime \_\_\_\_\_ 8 deputet .

Kryetari konstaton se z. Altay suroy, është emëruar zëvendësministër i drejtësisë.

Në fund të Seancës, kryetari Kuvendit i njoftoi deputet se do të jenë në pushim deri më 25 gusht 2006, duke iu dëshiruar pushim të këndshëm .

Kryetari e deklaroi seancën e mbyllur në orën 11,40 minuta

**Shënim :** Pjesë përbërëse e këtij Procesverbali është transkripti nga kjo seancë .

Kryetari i Kuvendit të Kosovës ,  
**Kolë BERISHA**

**E hartoi :**

Seksioni për Çështje Plenare e Procedurale.